



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

**THIRRJE PËR APLIKIM PËR BURSË STUDIMI NË PROGRAMIN MASTER TË  
OFRUAR NGA UNIVERSITETI KOMBËTAR KAPODISTRIAN NË ATHINË**

Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Athinë njofton mbi ofrimin e bursave për programin e studimit pasuniversitar njëvjeçar, Master “Studime mbi Evropën Juglindore – Politikë, Histori dhe Ekonomi”, për student me prejardhje nga vendet e Evropës Juglindore.

Ky program pasuniversitar i ofruar nga Universiteti Kombëtar Kapodistrian në Athinë, në gjuhën angleze, ofron mundësinë e studimit të çështjeve si autokracia, ndërtimi i një shteti, menaxhimi i azilit dhe migracionit, kriza ekonomike, politikat klimatike, zgjidhja e konflikteve dhe zgjerimi i Bashkimit Evropian. Qëllimi i këtij programi ndërdisiplinor është të bashkojë të rinjtë nga e gjithë Evropa Juglindore për të mësuar nga njëri tjetri dhe mes tyre.

Kandidatët e interesuar për këto bursa studimi mund të kontaktojnë departamentin në adresën elektronike: [postgrad\\_SEE@pspa.uoa.gr](mailto:postgrad_SEE@pspa.uoa.gr), në numrin e kontaktit +30 210 368 89 65, si dhe në faqen web: [see.pspa.uoa.gr](http://see.pspa.uoa.gr).